



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 31/08

Prishtinë, më 26.11.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Naser Osmani.

Anëtarët jo të pranishëm: Xhevdet Neziraj, Riza Smaka.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, Bedri Hamza, zv.ministri i MEF-i, përfaqësues nga AKP-ja, Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-019 për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente
5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3481/6 dt. 18.11. 2008 së Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave tatimore
6. Të ndryshme

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Faljen me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se amendamentet e propozuara nuk implikime buxhetore, andaj kërkoi që të mbështesin atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Faljen dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
 - II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- ### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, me amendamente**

Kryesuesi, theksoi se amendamentet e propozuara nuk implikime buxhetore, andaj kërkoi që të mbështesin atë.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
 - II.** Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- ### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-019 për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

Kryesuesi, njoftoi se kemi të bëjë me amendamentet të cilat Komisioni i ka shqyrtuar njëherë dhe ka konstatuar se kanë implikime buxhetore. Më pas Komisioni funksional i ka riformuluar ato duke i pasur parasysh vërejtjet. Në këtë raport shifet amendamenti i një deputete i cili nuk është

përkrahur nga komisioni funksional dhe i njëjti nuk duhet përkrahur sepse shkakton implikime buxhetore.

Shkumbin Demaliaj, duke komentuar amendamentin në fjalë theksoi se nuk duhet përkrahur edhe për faktin se duhet bërë decentralizimi i ofrimit të shërbimeve sociale, kur dihet se komunat nuk kanë marrë raport nga Qendra Sociale.

Stafete Hadërgjonaj, theksoi se amendamenti i propozuar ka qëllim të mirë, por në mungesë të arsyeshmërisë së përbërjes së Qendrës nuk mund të konstatohet kostoja financiare e tij dhe implikimet e mundshme buxhetore.

Naser Osmani, kërkoi të votohen dhe përkrahen vetëm amendamentet që i ka përkrahur komisioni funksional.

Kryesuesi, u pajtua me mendimin se qëllimi është i mirë, por theksoi se propozimi është joadekuat, mungon struktura e Qendrës Sociale për të vlerësuar koston financiare.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
 - II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 3481/6 dt. 18.11. 2008 së Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave tatimore**

Kryesuesi, njoftoi se pas kërkesave të bërë nga komisioni për kompletim të CV-ve për kandidatëve për emërim në të anëtarëve në bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave tatimore, ato janë plotësuar, prandaj kërkoi nga deputetët ta mbështesin atë për ti rekomanduar Kryesisë për radhitje në seancë plenare.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohet propozim-vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore.
- II. I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të njëjtën ta radhitë në rend të ditës për seancën plenare dhe të procedohet me nominimin e anëtarëve të bordit të pavarur për rishqyrtimin e ankesave tatimore.

6. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi për një kërkesë të sekretarit të Kuvendit, i cili përcjell qëndrimin e Kryesisë që Komisioni për buxhet dhe financa të bëjë propozimin dhe mënyrën e realizimit të kompensimit të nënkryetarëve dhe deputetëve që janë anëtarë në dy komisione për periudhën shtator-dhjetor 2008. Propozoi që shumica e kompensimit të jetë 50 % për nënkryetarët nga mëditja që merr kryetari dhe 50 % nga deputetët që marrin meditje për pjesëmarrje në komisione. Njëkohësisht në këtë kërkesë kërkohet mbështetja e disa praktikantëve me buxhet të Kuvendit nga viti 2009, të cilët deri më tani i ka mbështetur OSBE-ja.

Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës, theksoi se kërkesa ka të bëjë me kompensimin e nënkryetarëve dhe deputetëve që janë anëtarë në dy komisione. Ndërsa tjetra ka të bëjë me krijimin e një zëri buxhetor për pagesën e praktikantëve për vitin 2009, të cilët do të pranohen në dy turne nga dhjetë, dhe është planifikuar të paguhen në shumën prej 90 € të cilët do t'iu ndihmojnë komisioneve dhe do të kenë një orar prej katër orësh në ditë.

Haki shatri, mbështeti propozimin në vlerën prej 50 % për kompensim në periudhën e paraparë.

Besa Gaxherri, u pajtua që kjo shumë të jetë 50 % për vitin 2008.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni i propozon Kryesisë që në periudhën shtator-dhjetor 2008 të bëjë kompenzimin e punës së nënkryetarëve të komisioneve parlamentare dhe të deputetëve që janë anëtar në dy komisione si në vijim:
 - Nënkryetarët e komisioneve parlamentare për punën e tyre të kompenzohen në vlerën prej 50 % të mëditjes që marrin Kryetarët e komisioneve parlamentare.
 - Deputetët që janë anëtar në dy komisione për punën e tyre të kompenzohen në vlerën prej 50 % të mëditjes së tyre për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve parlamentare.

Kryesuesi, njoftoi për ftesën e bërë nga OSBE-ja për pjesëmarrje në një tryezë të nivelit rajonal me temën: Raporti i parlamentit në mbikëqyrjen financiare dhe Zyra e Auditorit. Ftesa i është bërë Kryetarit dhe dy anëtarëve tjerë. Propozoi që nga opozita të jetë znj. Besa Gaxherri dhe z. Naser Osmani. Të njëjtat propozime u mbështetën.

Haki Shatri, njoftoi për takimin e zhvilluar me përfaqësuesit e GTZ dhe premtimin që kanë marrë nga ata se do të sjellin dy ekspertë nga Gjermani për të ofruar përvojat e tyre në punën me buxhet dhe organizatat buxhetore, të cilat do të mund të na shërbenin në këtë fazë të shqyrtimit të buxhetit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:47

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI